



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa
Prishtinë, më 30.08.2007, ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë nga Komisioni: Naser Osmani, Ali Sadriu, Safete Hadergjonaj, Gani Koci, Nazim Jashari, Mazllom Kumnova, Lutfi Zharku, Snezhana Miliç dhe Naxhije Doçi,

Ndërsa mungoj; Rifat Krasniq Besa Gaxheri, dhe Demir Limaj

Nga zyra e komisioneve të Kuvendit : Natasha Prica Zyrtare e lartë Ligjore, Ahtere Loxha zyrtare ligjore dhe Arta Hajra asistente Ligjore.

Në mbledhje morën pjesë të ftuar Zv. Ministri për Ekonomi dhe Financa Behxhet Brajshori me bashkëpunëtorët: Agim Kraniqi, Zilif Luti dhe Lulzim Salihu .

Mbledhjen e monitoruan zyrtarët nga Presidenca OSB, NDI dhe KDI.

Mbledhjen e kryesoi kryetari i komisionit **Naser Osmani**,

Kryetari hapi mbledhjen ,përshëndeti të pranishmit dhe propozoi këtë:

Rend Dite

Shqyrtimi i raportit fiskal për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2007.

Kryetari përshëndeti zv. Ministrin për ekonomi dhe Financa me bashkëpunëtorët dhe tha se sipas Ligjit për menaxhimin e financave neni 40 , MEF është e obliguar që në Kuvend ti sjell raportet periodike, ne e kemi marr raportin me kohë dhe kemi pas mundësi me shqyrtua . Nëse janë edhe mediat prezent, në emër të komisionit dua ta bëjë edhe një herë një vërejtje drejtuar Zyrës së Auditorit Gjeneral ,njëherit Komisioni për Buxhet dhe financa respektivisht Kuvendi kërkon nga Zyra e Auditorit gjeneral që ti raportoj Kuvendit për të gjitha auditimet e bëra siç është paraparë në Rregulloren në fuqi dhe kërkon të nxirret ligji për auditimin e jashtëm dhe të krijohet një relacion i

ri mes Zyrës së Auditorit gjeneral dhe Kuvendit në mënyrë që ti kemi raportet e auditimit për të gjitha institucionet .Në vazhdim ia dha fjalën zv. Ministrit .

Behxhet Brajshori tha se raportin financiar për gjashtëmujorin e parë e keni marr në afatin kohor siç parashihet me ligjin dhe në vija pak më të trasha dua ti theksoj disa indikator që kanë të bëjnë me proceset buxhetore në kuptim e të hyrave dhe të dalave.

Të hyrat kanë një trend të ngritjes dhe të hyrat e grumbulluara gjatë gjashtë mujorit 2007 paraqesin 65.4% të planit vjetor nëse e krahasojmë me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar dhe krahasuar me atë që është planifikuar për periudhën janar –qershor 2007 kemi ngritje substanciale të të hyrave për 30.9% më shumë dhe krahasuar me vitin e kaluar ato janë 35.7 % më të larta. Keni mund të vëreni se cilat kanë qen kategoritë me të hyra më të mëdha ..

Pjesa më e madhe e të hyrave buxhetore janë mbledhur në kufi, tatimet në dogana kanë një ngritje 53.9% .Tatimet vendore për 57.4 %, të hyrat jo tatimore 72.5%, të hyrat vetanake të nivelit qendror për 11.2%. Komunat po ashtu krahasuar me progresin e planit kanë arrit 48.4% të planit të realizuar. Sa i përket shpenzimeve progresi ndaj buxhetit të vitit 2007, janë realizuar 37.0% të shpenzimeve. Krahasuar me planin janar –qershor janë 74% dhe krahasuar me periudhën e njëjtë kemi rritje të shpenzimeve për 9.9%.

Në total të hyrat periudhë për periudhë kanë një ngritje prej 35.7%.

Të hyrat nga licenca e telekomunikacionit janë 75 mil €dhe janë të hyra që nuk janë planifikuar me buxhet dhe janë paraqit si kategori e veçante.

Të hyrat nga ATK-ja në gjashtëmujorin e vitit 2007 janë më të ulta për 10% se sa në vitin 2006 për shkak se në gjashtëmujorin e vitit 2006 është arkëtuar extra profiti i viteve të më pasme..

Rrogat dhe mëditjet periudhë për periudhë kanë pas një ngritje sipas kategorive.

Rrogat dhe mëditjet në gjashtëmujorin 2007 janë më të larta për 3% se periudha e njëjtë e vitit 2006.

Te mallrat dhe shërbimet kemi rënie të shpenzimeve për 5%se sa në periudhën e njëjtë e vitit të kaluar.

Shërbimet komunale janë për 8.3% më të mëdha , subvencionet dhe transferet për 12.1%, kurse shpenzimet kapitale janë të realizuara 63.6%.

Te pagat ngritja është bërë sepse është aplikuar udhëzimi administrativ dhe me disa memorandume të mirëkuptimit që janë realizuar me kohë, ku është bërë llogaritja e kujdestarive në ministrin e shëndetësisë për mes sistemit të pagave , pastaj pagesa e antarëve të Kuvendit me Rregulloren e Kuvendit etj.

Në përgjithësi kemi një trend pozitiv të hyrave, kemi një balancë të shpenzimeve , mirëpo shpenzimet kapitale mbeten akoma çështje që duhet kujdesur në total, implementimi i shpenzimeve kapitale kërkon një efikasitet pak më të madh sepse akoma nuk është niveli i kënaqshëm i realizimit të shpenzimeve, përkatësisht i projekteve, arsyeja mbetet e njëjt që e kemi përmend disa herë e ato janë procedurat e ndryshme të prokurimit dhe aspektet tjera që ndikojnë në shfrytëzimin e mjeteve. Në vazhdim tha se do të ju jap fjalën kolegëve të thesarit dhe buxhetit .

Zylyf Luti e konsideroj këtë raport si të nivelit të konsoliduar dhe tha se do të përgjigjemi me evidencë për të gjitha organizatat buxhetore që kërkohen nga ju ,ndoshta ka ndonjë mangësi dhe vërejtjet e juaja do ti marrim si pozitive dhe do ti bashkangjesim të përmirësuar për periudhat e ardhshme që pasojnë.

Agim Krasniqi tha se ky raport te pjesa e të hyrave dhe shpenzimeve ndryshon nga Rregullorja e buxhetit dhe bashkërisht jemi duke u munduar që raportet e ardhshme ti merrni në format më ndryshe për me qenë më e qartë për ju.

Kemi menduar që pjesa e parë të jetë çështja e Rregullores,pjesa e dytë, të hyrat vetanake , pjesa e tretë me i pas Grantet dhe në fund Raporti i konsoliduar.

Kur bisedojmë për këtë raport 6 mujor planifikimi i shpenzimeve jepet në mënyrë lineare. Në raportin tjetër 9 mujor do të jetë plani rrjedhës i parasë, qysh i planifikojnë organizatat buxhetore dhe

si janë shpenzuar dhe aty do të tregohet më detalisht dhe do të jetë më e kuptueshme për të gjithë. Pra jemi duke bisedua për të pas një raport më kualitativ për 9 mujorshin e këtij viti.

Më tutje tha se fjalën suficit mos e merrni si suficit, sepse ai është bilanc bankar pas gjashtë mujorit, sepse projektet që kanë filluar janë angazhuar dhe nuk janë përfunduar sepse në fund të kryerjes së punimeve paguhen, varësisht si e merrni këtë raport do të nxjerrni konkludime të ndryshme. Organizatat buxhetore e kanë kuptuar mesazhin që bashkërisht e kemi dhënë më herët, që projektet të fillojnë më herët dhe në bazë të informatave që kemi shumica e projekteve do të realizohen brenda këtij viti.

Kryetari mendoj se ky është një kontinuitet i raporteve të kaluara, ku përdoret metoda e krahasimit dhe përafërsisht është një strukturë e njejtë e të hyrave.

Vërehet një përpunim jo i detalizuar dhe konsideroj se raporti duhet të plotësohet edhe me më tepër elemente, ka nevojë për një perfeksionim sidomos për disa shuma që nuk janë të saktësuara sepse mungon arsyetimi për prejardhjen e tyre dhe konsiderohen si të hyra sepse mungojnë sqarimet nga bankat, është brengosësh çështja e investimeve kapitale ku e përmenden zv. Ministri dhe drejtori sepse kjo reflekton edhe te komunat, nuk e di sa është e saktë tabela në faqe 10 që ka të bëjë me komunat, është shumë brengosëse sepse ka një strukturë në përqindje shumë të vogël.

Ndërsa në një shikim më të detajizuar të dalurat dhe shpenzimet kapitale ish dashtë të shpjegohen më mirë pse është kjo përqindje në 18.3%. Për ne do të ishte shumë me rëndësi, sikur do të kishim të dhëna më të detajizuara sepse jemi në procesin e hartimit të buxhetit për vitin e ardhshëm dhe sipas disa bisedave ne do të mundohemi që kësaj here të bëjmë një ndërhyrje më të madhe.

Më intereson të dijë se çka ka ndodhur me Agjensionet e pa varura, sidomos me Agjensionin Antikorupcion i cili ka kalu të gjitha nivelet e aprovimit dhe nuk është inkorporua në buxhetin e Kosovës.

Safete Hadergjonaj kishte vërejtje ndaj stafit në shpërndarje të materialit, sepse tha se nga MEF në Kuvend raporti ka ardhë me 28.07.07, kurse neve na është shpërnda nëpër kutia 3 ose 4 ditë para se ta shqyrtojmë në mbledhje dhe i mungojnë faqet prej 11 deri te faqja 16.

Sa i përket raportit e kam shikuar dhe kam konstatuar se ka konfuzitet në mënyrën e krijimit të hyrave dhe shpenzimeve. MEF deklaroi se ka bërë një rritje të hyrave dhe si qëndrimi ynë ka qenë, se që në fillim është bërë një planifikim jo real i burimeve financiare nga të cilat krijohen të hyrat dhe tani del se paskemi rritje të hyrave. Ajo çka konsideroj se nuk është mirë është se të hyrat ende po sigurohen nga doganat, kurse pjesa e të hyrave nga brenda po mbetet në kufirin e njejtë.

Kam vërejtje në mënyrën e krijimit të hyrave të brendshme si janë paraqitur në raport. Për neve do të ishte me rëndësi si komision për Buxhet të kemi informatë se sa janë borxhet ndaj Administratës tatimore të Kosovës (ATK) dhe si ka paraparë ATK ti inkasoj këto borxhe sepse dihet se janë më shumë se sa krijohen të hyra brenda vitit.

Sa i përket shpenzimeve, MEF del se ka bërë një ulje të shpenzimeve, buxheti krijohet për tu shfrytëzua me efikasitet dhe efektivitet e jo për të tepruar mjetet, sepse edhe kur teprjnë mjetet është një shenjë se nuk është planifikua mirë dhe nuk është realizua mirë buxheti. E keqja është se ne si komision asnjëherë nuk e kemi pas në mënyrë të detalizuar si është planifikuar buxheti, ne nuk e dimë se në cilat pozicione është orientua nuk kemi pas një rekapitullim sa do të ketë për mallra dhe shërbime, shpenzime kapitale, komunale, për paga dhe mëditje, kështu që është problem për ne të vijmë në përfundim, se a kanë shkuar aty ku janë planifikua mjetet edhe pse kemi mjaft informata se mjetet nuk kanë shkuar aty për çka janë planifikua. Ende mbetet mjaftë shqetësuese çështja e shpenzimeve kapitale, zv. Ministri më parë tha se kemi një rritje të shpenzimeve kapitale në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, por gjendja faktike sipas këtij raporti del se 14 organizata buxhetore e kanë përqindjen zero në shfrytëzimin e mjeteve buxhetore, kurse 12 organizata buxhetore e kanë nën 5% shfrytëzimin e mjeteve kapitale.

Te pagat, me rëndësi është të na jepet një shpjegim më detal për mëditjet me orar të shkurtuar që kapin shifrën prej 3,557,001 të na sqarohet se për çka është fjala.

Tek shpenzimet për mallra dhe shërbime nuk shihet ndonjë ndryshim i madh nga viti i kaluar sepse

ende mbesin në ato dukuri që kanë qen dhe mendoj se janë pak të tepruara. Pastaj te mirëmbajtja shuma prej 7 Mil € është jashtë normales, po ashtu për shërbimet kontraktuese kam një dilemë janë 6Mil pa dashtë të hyjë në detalizimin e këtyre shpenzimeve.

Kërkoj shpjegim se për çfarë transferesh është fjala kur përmenden transferet e brendshme janë disa shuma këtu ..

Pasi përfaqësuesit e MEF ishin prezent tha se dua të ndalem te shpenzimet pa hyrë në organizata tjera buxhetore .

Më intereson si janë shpenzuar për udhëtime jashtë vendit shuma prej 273,747.82€. Pastaj te mirëmbajtja shuma prej 7 Mil € është jashtë normales, po të kishin udhëtuar të gjithë punëtorët jashtë vendit nuk do të shpenzohej kjo shumë, duke i llogaritur edhe avanset prej 107,332.8, po ashtu për shërbimet kontraktuese janë 6Mil, kurse për akomodim janë shumat prej 102,474,68,

Pastaj shpenzimet për telefona 218 mi € mendoj se janë të tepërta shpenzimet për dreka zyrtare 136,903, për këshilldhënie janë 360 mi €, sikur vërtet do të ishin këto këshillime të mira do ta kishim një buxhet ma të mirë, do ta kishim një inkasim më të mirë dhe planifikim më të mirë .

Si MEF do të ishte mirë ta njoftoni komisionin te administrata tatimore , si janë të përcaktuara shtesat e punëtorëve dhe a ka rregullativ ligjore për këtë shpërndarje.

MEF me shumë organizata buxhetore ka lidh marrëveshje mirëkuptimi, më intereson të dijë se a keni bërë ndonjëherë kontroll të këtyre marrëveshjeve të mirëkuptimit se si po realizohen ato dhe a ka ndonjë organizatë buxhetore që krijon të hyra dhe nuk keni marrëveshje të mirëkuptimit me ta. Në fund si janë dhënë KEK-ut 75mi € dhe askund nuk po figuron si janë bërë këto lëvizje.

Mazllom Kumnova parashtroi disa pyetje lidhur me raportin dhe tha se .

1. Të hyrat e grumbulluara kanë një tregues optimist dhe shpenzimet e realizuara janë nën planifikim, a ka gjasa të ndryshohen këto parametra apo do të vazhdojnë me këtë trend.

2. Në raport askund nuk figurojnë mjetet e destinuara për grupin e unitetit.

3. Të hyrat e nivelit qendror shuma e realizuar nga gjobat është e lartë , pastaj të hyrat nga inspektimi gjithashtu a janë të njëjta apo jo.

4. Te shpenzimet buxhetore sipas klasifikimit ekonomik dhe funksional mbrojtja e mjedisit është zero, çka nënkupton kjo?

Lutfi Zharku parimisht kërkoj disa sqarime nga përfaqësuesit e MEF.

Kërkoj të ipen sqarime më në detale lidhur me depozitimin e parasë publike në autoritetin qendror bankar , arsyeshmërin e ndarjes së këtyre parave

2. Te administrata tatimore , tatimi i korporatave nuk ka qenë e zakonshme deri tash, a është çështja e pagesës së PTK-së dhe a është rit me të vërtet.

3. Qka nënkupton te administrata tatimore -Konto Kaluese

Nazim Jashari vlerësoi se raporti si raport në aspektin teknik është i varfër shumë pa u fut fare në detale dhe për të ardh deri te një pasqyrë e qartë të rrjedhës së parasë duhet me i qel njëhësisht edhe disa dokumente tjera, Janë dhënë krahasimet e shpenzimeve në gjashtëmujorin 2007 me gjashtëmujorin e vitit 2006, është dhënë edhe progresi ndaj vitit 2006, por është dashtë të jepet edhe progresi për vitin 2007 pra është me rëndësi të paraqitet progresi në bazë të planit , prandaj konsideroj se ky raport duhet të plotësohet me shënime të reja për ta pas një pasqyrë të qartë.

Ali Sadriu tha se materiali i ofruar është material burimor i marrur nga thesari ku jepen pasqyra për transaksione që kanë ndodh, por mendoj se ky raport është dashtë të plotësohet edhe me analiza , komente dhe rekomandime, por për tu bërë këto është dashtë të kyçet edhe departamenti i buxhetit Raporti është dashtë të paraqitet me të gjitha shpenzimet .Pra në raportet e ardhshme që duhen të jenë ma complete duhet të kyçet departamenti i buxhetit dhe departamenti i politikave makroekonomike .

Gani Koci vlerësoj se në këtë raport janë përdorur disa terme që deri tani nuk janë dhënë në raportet e deritanishme andaj kërkoj sqarim se çka nënkuptohet me pasuri jo financiare, a nënkuptojnë këto shpenzime kapitale dhe pse quhen kështu.

Në projektligjin e buxhetit kemi pas një përmbledhje të projekteve kapitale të nivelit qendror me një shumë e paracaktuar dhe që ka ndryshuar tani, Duke pas parasysh shkallën e ultë të shpenzimeve kapitale, ministria këtij raporti duhet bashkangjitur edhe të gjitha projektet që janë miratuar në projektbuxhet dhe përafërsisht të na tregojnë se në cilën shkallë të realizimit janë, sepse është e pa arsyeshme se gjithnjë shpenzimet kapitale në fund po na mbesin tepër të mjeteve për shpenzimet kapitale.

Por dua tu them se Ligji për prokurimin publik nuk është pengesë për realizimin e prokurimeve publike, siç u tha më par, por pengesë është mënyra se si dhe kush i zhvillon procedurat.

Çart në Ligjin për prokurimin publik në kreun e shtatë të këtij ligji thuhet se sa ditë pas miratimit të ligjit Agjensionet e prokurimit publik duhet ti bëjnë kërkesat dhe të qohen raportet me të gjitha prokurimet e detajizuara. Konsideroj se në këtë duhet të përshkruhet qartë se kur duhet filluar projekti e kur duhet përfunduar në mënyrë që agjensioni të fillojë procedurat e tenderimit dhe prokurimit të saj. Shtroj pyetjen; se sa është zbatua ky nen i Ligjit dhe sa ka ndikuar ministria përkatese zbatimin e kësaj. Pastaj neni 6 i Ligjit të buxhetit për këtë vit thotë se brenda 30 ditëve duhet të njoftohet Kuvendi për të gjitha mbetjet buxhetore nga viti i mëparshëm dhe ju këtë nuk e keni bërë. Respektimi i ligjit fillon nga ju, se edhe sipas Ligjit për menaxhimin e Financave, Ligji për Buxhetin fiskal dhe Ligji për Prokurimin publik përgjegjësia bie tek ju.

Ali Sadriu tha se duhet një arsyetim pse ka mbetje të mjeteve të lira dhe duhet një arsyetim detal se cilët faktor kanë ndikuar që nuk janë realizuar projektet.

Zv. Ministri u përgjigj në pyetjet e parashtruara nga anëtarët dhe tha se të hyrat planifikohen sipas kapacitetit që mund të llogariten dhe struktura e të hyrave është e përcaktuar me ligj, janë të hyrat nga doganat të hyrat e brendshme dhe të hyrat nga tatimet.

Shpenzimet në total kanë një ngritje krahasuar me vitin e kaluar, por në strukturë të brendshme aty ka rënje dhe të gjitha shpenzimet janë në kuadër të limiteve buxhetore dhe janë të bazuara në Rregullat financiare. Agjensionet shpenzuese mjetet e veta i menaxhojnë mjetet e veta në bazë të rregullave dhe në kuadër të limiteve buxhetore.

Sa i përket suficitit prej 170 mil € nuk është suficit, kjo është rrjedhë e rregullt e parasë sepse suficit mund të llogarisim në fund të vitit në gjysmën e vitit suficit nuk ka.

Krahasimet në periudhë të njëjtë me të vitit kaluar janë paraqitur në raport, periudhë për periudhë në krahasim me planin, por jo në mënyrë të detajuar.

Kurse sa i përket asaj se a ka Marveshje të mirëkuptimit, tha se ka por nuk e di me sa agjensione, ekzistojnë kriteret dhe limitet në bazë të cilave agjensionet i shpenzojnë mjetet e veta dhe sa shkojnë në buxhetin e Kosovës.

Ka marveshje që ne i përcjellim dhe janë kriteret në bazë të cilave kriterëve bëhet ndarja e tyre që kanë mund të realizohen në bazë të marveshjes.

Shpenzimet kapitale të komunat vazhdimisht kanë qenë dhe janë breng, sepse nuk janë në nivelin e duhur edhe pse disa prej tyre e kanë ritatimin në pronë dhe shumica prej tyre e kanë mbërritur kriterin për të marrë grantin për vitin e ardhshëm. Ka një lëvizje të mirë.

Nëse e marrim shkallën e realizimit të projekteve është vështirë me caktuar se sa mjete janë pagu për një periudhë të caktuar, sepse raporti tregon shpenzimet e mjeteve që janë paguar.

Pajtohem të përcillen edhe Ligji i prokurimit edhe ligjet tjerat simbasë asaj që parashihet dhe agjensionet shpenzuese janë të obliguara me paraqitjen e planit të prokurimit dhe me njoftimin edhe MEF se çfarë planesh kanë, në këtë drejtim po ka progres edhe në trajnim të kuadrove por natyrisht nevojitet kohë për ta zënë hapin.

Pajtohem që sipas mundësisë raporti të jetë më detal dhe në raportet vjetore të përfshihen të gjitha

dhe ti bashkëngjitet shkalla e realizimit të projekteve raportit ,të jetë një transparencë e përgjithshme sipas Ligjit të menaxhimit të financave pajtohem edhe të jepen rekomandimet për agjensionet shpenzuese .Por ky është raport gjashtëmujor që në formën e vet është pasqyrë .

Lulzim Salihu dha sqarim rreth dizajnit të raportit shprehjeve të terminologjisë që kanë pësuar ndryshime. Në fillim të këtij viti tha se banka botërore ka nda një donacion për përpilim të manualeve për aktivitete të thesarit Shumica e terminologjis ,tabelave dhe formave që janë paraqitur janë përshtatur sipas standardeve ndërkombëtare duke u bazu në para të gatshme dhe në bazë të rekomandimeve të ekspertëve që i ka angazhua banka botërore .

Çështja e transfereve të brendshme ka të bëjë kryesisht me punën e organizatave buxhetore d.m.th ,nëse një organizatë buxhetore i kryen organizatës buxhetore punë, kjo nuk shkon për mes bankës por është transfer i brendshëm apo transfer për palë të treta .

Te investimi i parave publike ne kemi formu një komision për investimin e parave publike,banaka qendrore po ofron interesa në baza afatshkurta duke u bazua në bankën qendrore Evropiane në Frankfurt dhe në këtë princip në baza afat shkurtë jemi duke bërë

investime të parave publike një javore dy javore në mënyrë që të ritet tërësia e parave publike.

Ne jemi të gatshëm tu ofrojmë të dhëna shtesë për secilin pozicion. Sepse është e pa mundur të paraqiten të gjitha.

Sa i përket termit pasuri jo financiare ka të bëjë me investime kapitale.

Zilif Luti: Lidhur me konton kaluese prej 16 mil €, ato janë para që janë grumbulluar në llogari të thesarit në emër të administratës tatimore të cilat deri me datën 30 qershor nuk kanë mundur të specifikohen nga administrata tatimore sipas karakterit, por janë si të hyra publike që kanë mbërritur në buxhetin e konsoliduar të Kosovës.

Lutfi Zharku pyeti se tatimi për korporata prej 25 mil i paraqitur, a është i PTK-ës.?

Zilif Luti tha se është se është buxhet i planifikuar për të gjitha korporatat.

Agim Krasniqi; Ky raport për gjendjen faktike nuk ka dokumente shpalose përcjellëse që juve ju intereson e thash edhe në fillim që jemi në bisedime që së bashku raporti i buxhetit me raportin e thesarit të bëjnë plotësime.

Sa i përket investimeve kapitale shumica e organizatave buxhetore planifikojnë me i nis punët në çerekun e dytë të vitit, mjetet i kanë zotuar i kanë lidh kontratat organizatat buxhetore, punët kanë filluar ,por nuk kanë fillua pagesat, lidhur me këtë duke i pas parasysh brengat që i kemi ne dhe ju për investimet kapitale ne kemi bërë një raport te nën shpenzimet ku janë dhënë disa arsye që tregojnë pse është niveli i tillë i nën shpenzimeve dhe çka duhet bërë për me u përmirësua , që ai nivel i nënshpenzimeve me u përmirësuar te çështja e investimeve kapitale. Janë rekomandimet dhe Ganiu ka të drejt që thotë se Ligji për prokurim nuk është pengesë ,por ka edhe raste që Agjensioni publik pa të drejt e ndal tenderin pse ankohet ndonjë shoqatë. Prandaj në këtë drejtim duhet punuar me Agjensionin publik, organizatat buxhetore kanë mundësi me i fillua me kohë prokurimet dhe procedurat.

Ky raport nuk mundet me tregu gjendjen në detaje, prandaj është mirë që edhe ne dhe ju i kemi bërë vërejtjet në at drejtim dhe së bashku do të bëjmë presion që organizatat buxhetore në procedura edhe të projekteve edhe të tenderëve të mëdha të kalojnë në mënyrën tjetër të pregaditjes së buxhetit. Sa i përket asaj se sa mundemi ne me ju dhënë raport për secilën fazë të projektit, aty ne nuk mundemi me ju ndihmuar sepse organizatat buxhetore nuk i kanë sjell raportet mbi baza tre mujore se në cilën fazë janë procedurat por duhet së bashku me ta me i disiplinuar për me mundur me i pregadit me kohë.

Sa i përket shpenzimeve pse janë më të mëdha vetëm një element po ua jap.

Ju e dini se vitin e kaluar janë bartë te komunat edhe kanë me u bartë edhe sivjet pjesa e të hyrave vetanake dhe kjo me ligj është e rregulluar. Pjesa më e madhe e të hyrave vetanake nëpër komuna

realizohen në gjashtëmujorin e dytë, çdo gjashtëmujor fakturat e tatimit ndërrohen dhe për mos me u pengu komunave i është dhënë mundësia që ato me u bartë. Pjesa më e madhe e të hyrave vetanake që realizohen janë për projektet e investimeve dhe nga ky pozicion vitin e kaluar kanë qenë 26. Mil€ dhe ato e kanë rit nivelin total të shpenzimeve.

Sa i përket Agjensionit Antikorupcion është aprovu Kuvendi, por nuk është përcjell drafti i fundit për nënshkrim nga PSSP-ja, por është përcjell vetëm drafti i parë, teknikisht stafi nuk e ka pregadit pasi që është marrë vendimi. Më vonë Qeveria ka marrë një kërkesë nga Agjensionit dhe ka vendos për fillim me rit numrin e punëtorëve prej 8 në 15 por jo 35 sa ka qenë në fillim dhe varësisht prej nevojës se si do të shkon vëllimi i punëve është mëndu që ai buxhet të plotësohet, do të thotë juridikisht nuk është përcjell komplet vendimi që është nënshkruar prej Kuvendit.

Kryetari ndërhyri dhe tha se Kuvendi e ka votuar në mënyrë të veçantë çështjen e Agjensionit Antikorupcion, Këshilli Fiskal e ka aprovua vendimin e Kuvendit dhe ne kemi menduar që kur e merni prej Këshillit Fiskal aty inkorporohet çdo gjë e përmenda me qëllim se Kuvendi nuk është autoriteti i fundit.

Agim Krasniqi tha se vitin e kaluar nëse ju kujtohet pas mbledhjes së fundit të Kuvendit nuk ka pas më këshillim nga Këshilli ekonomik fiskal.

Kryetari vlerësoi se përshtypja e komisionit është se ky Agjension po injorohet dhe nuk po mundet me ardh në shprehje.

Agim Krasniqi tha se ju po e lexoni raportin e shpenzimeve, të gjitha organizatat buxhetore kanë filluar me shpenzimet.

Akademia e shkencave kanë njoftua se nuk kanë kapacitete me menaxhua me një projekt të madh prej 1 Mil sepse nuk kanë njerëz të prokurimit, për at arsye është shikuar mundësia kush me kryer punën për ta dhe nga Qeveria është vendos që punën për ta mundet me kryer departamenti për inzhiniering dhe ndërtimtari nga ministria e shërbimeve publike

.Çështja e memorandumeve të mirëkuptimit është e rregulluar me ligj. Memorandumet e mirëkuptimit kanë për qëllim që organizatat buxhetore që realizojnë të hyra me i përdor, por jo për përmirësim të bazës materiale por me i përdor për shpenzime tjera që nuk i kemi nda me buxhet të rregullt. Interesimi i jonë është që një pjesë e këtyre të hyrave të shkojnë në buxhet, nuk është diçka e re se ekzistojnë në çdo vend në botë, interesimi ynë është që me u përcaktua me përqindje sa do ti shkojnë organizatës buxhetore dhe pjesa tjetër e këtyre të hyrave do të përdoren për tu mbulu nevojat për mallra dhe shërbime dhe investimeve kapitale, por një pjesë e këtyre të hyrave duhet të derdhen në buxhet të konsoliduar të Kosovës.

Sa përket 75 Mil € për huan e dhënë Kekut nuk figurojnë në raport, sepse juridikisht është duke u punu drafti se në cilat kushte ka me u dhënë kjo hua dhe në cilat kushte ka me u inkorporua vendimi i Qeveris dhe kjo nënkupton jo me u nda mjetet për këtë vit por për vitin 2009, me përjashtim që janë 7.5 mil që janë për eskavator në mihjen e Bellaqevcit.

Në pyetjen e parashtruar nga z. Mazllom tha se çështja e shpenzimeve nuk do të vazhdoj me këtë nivel, sepse te shpenzimet kapitale kanë fillu me u e realizua projektet, ka pengesa në disa ministri por jam i sigurt se sivjet do të shkoj më mirë sivjet pjesa e realizimit të projekteve, sepse projektet kanë filluar sepse ne kemi dal me i monitorua dhe kemi pa se projektet kanë fillua.

Te MEF nga shumat që janë paraqitur, diku 1 mil e 100 mi€ janë të Fondit për bisedime, kurse pjesa tjetër 3.3 Mil shpenzimet pas statusit nuk janë prek fare, pjesa më e madhe e këtyre shpenzimeve që i përmendet për udhëtime janë shpenzime që janë bërë për udhëtimet e delegacioneve që janë bërë për bisedime ku përfshihen akomodimet dhe shpenzimet për telefon etj. dhe nuk janë shpenzime të MEF.

Shpenzimet që kanë të bëjnë me administratën tatimore me shtesë për rrezikshmëri, është e paraparë në Rregullore dhe Ministri i MEF në bazë të Rregullores ka të drejt me vlerësua a mu bo ndarja për shtesë për shkak të rrezikshmërisë dhe shtesa tjera. Është duke u bë amendamenti i Rregullores së

buxhetit për tu ndërpre transferet te projektet kapitale dhe me udhëzim administrativ fundi i këtij muaji do të jetë afati i fundit për me u ndërpre praktika e viteve të mëparshme që mos me ekzistua mundësia e transfereve prej një projekti në një projekt tjetër. Në vitin tjetër së bashku me ju do ta kemi një nen të veçantë që do ta përcaktoj edhe mbrapa kategorisë ekonomike se në çfarë niveli mund të bëhet transferi. Nëse ju kujtohet së bashku vitin e kaluar e kemi hekë at nen dhe pasi e kemi hekë at nen , ju kemi lënë mundësin ministrave dhe qeveris për të vendos për transfero dhe rialokim të projekteve kapitale.

Sa i përket çështjes së transfereve edhe ne kemi shumë probleme sepse disa ministri ligjin po e kalojnë, është e precizuar në Rregullore të buxhetit se deri 20% të një kategorie të madhe ekonomike ministri i MEF ka të drejt të jap arsyeshmërin dhe drejtën për me leju transferin ,prej 20 deri 40% nevojitet pëlqimi i Qeveris dhe PSSP-së , mbi 40% nevojitet pëlqimi i Kuvendit dhe PSSP-së, në rastet kur neve na vjen kërkesa për mbi 40% siq është rasti me Ministrin e bujqësisë na jemi të obliguar me ja u bashkëngjijtë Kuvendit një dokument në të cilën jepet arsyeshmëria e Agjencionit dhe mbi bazën e kësaj e përgatisim një dokument tjetër përcjellës që ja dërgojmë juve dhe PSSP-së. Po ju garantoj se asnjë transfer PSSP-ja nuk ka bërë nëse kërkohet vendimi i Kuvendit dhe është mirë që këto vendime Kuvendi të na i qon më shpejt se po na vonohen shumë.

Gani Koci tha se sa i përket çështjes së Agjencionit antikorupcion jam pak i ndjeshëm, nëse Kuvendi ka mar një vendim dhe at vendim nuk e ka ndryshua Këshilli fiskal dhe as zyra e PSSP-së , pyes sa ju e keni zbatua pjesën normative të ligjit mbi shpenzimin e buxhetit për vitin 2007, pikërisht në kufizimin e marrjes së numrit të punëtorëve në këtë agjension , Ligji nuk jep të drejtën për kufizim e numrit. të punëtorëve , Kuvendi ka miratua numrin prej 35 punëtorëve dhe ka bërë ndarjen buxhetore të atij agjensioni dhe ju si ministri nuk keni respektua vendimin e Kuvendit. Ju përkujtoj lexoni nenin 7.5 të Ligjit për ndarje buxhetore për vitin 2007 dhe në mënyrë decisive shkruan se si duhet vepruar dhe ju keni vepruar kundër ligjit. Prandaj prej kë tu dalin kritikrat se e keni dit se Kuvendi ka mar një vendim dhe at vendim para se ta qoni në zyrën e nënshkrimit është dashtë ta analizoni mirë .

Agim Krasniqi duhet të kuptohemi drejt sepse pas mbledhjes së Kuvendit që ju e keni votu buxhetin ,ai buxhet ka shkuar direkt te PSSP-ja nuk ka shku në Këshillin ekonomik fiskal dhe këtu administrata nuk e ka përfshi vendimin tuaj .

Kryetari tha se kam biseduar në Këshillin ekonomik fiskal e kam pas fjalën hyrëse dhe kemi mëndu dhe kemi bisedua që me rishikim ajo me u përmirësuar.

Kryetari: Pas shqyrtimit të raportit gjashtëmuor për vitin 2007 komisioni nxorri këtë:

Përfundim

1.Rekomandon Kryesin e Kuvendit që në seancën e radhës së Kuvendit ta vejë në rend dite për shqyrtim.

2.Komisioni doli me konstatimin se ky raport nuk është i plotë ,ka nevojë për përmirësim si në aspektin teknik teknik ashtu edhe përmbajtjesor,të figurojnë tabelat e progresit ndaj planit për vitin aktual dhe progresit ndaj vitit të kaluar.

3. Sa i përket shpenzimeve të ndara për bisedime duhet të ketë një pozicion të veçantë dhe

4. Raportet e ardhshme të jepen më të detajizuara me pozicionin tabelor të investimeve kapitale me progresin e raporteve që realizohen dhe të plotësohen me analiza dhe komente.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00 .

Procesin e hartoi

Ahtere Loxha

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani